

VENDIM
Nr. 52, datë 7.3.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “ERALD ENERGJITIK” SHPK,
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s, NR. 91,
DATË 26.9.2011**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë të elektrike”; të nenit 18 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; të neneve 5, germa “a” dhe 6 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 58, datë 18.4.2017, pika 6.1, germa “a” e kushteve për “Licencën e prodhimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e nr. 99, datë 17.6.2016 të bordit të ERE-s, si dhe të nenit 19 të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2018, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Erald Energjitik” sh.p.k., me nr. 162, seria PV11K, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 91, datë 26. 9.2011,

konstatoi se:

- Subjekti tregtar “Erald Energjitik” sh.p.k., është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 91, datë 26.9.2011, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Shemri” dhe “Mgullë”, me licencën nr. 162, seria PV11K.

- “Erald Energjitik” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën me nr. 200 prot., datë 23.2.2018, për aprovimin e ndarjes së shoqërisë “Erald Energjitik” sh.p.k., në dy shoqëri, shoqërinë “Erald 2 Energy” sh.p.k. dhe shoqërinë “Leadd Energy” sh.p.k.

- ERE nuk është organi kompetent që miraton ndarjen e shoqërive tregtare.

- Në datën 16.2.2018, midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e autoritetit kontraktues dhe shoqërisë koncesionare “Erald Energjitik” sh.p.k., është lidhur një kontratë shtesë koncesioni me nr. 254 rep. dhe 132/3 kol., “Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën e koncesionit të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet METE-s dhe bashkimit të shoqërive “Oberaldi” sh.p.k. dhe “Lala” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve “Shemri” dhe “Mgullë”. Në këtë “Shtesë kontrate të koncesionit”, palët bien dakord si më poshtë:

1. Autoritet kontraktues është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

2. Koncesionar për HEC “Mgullë”, me fuqi të instaluar 280 kw dhe prodhim mesatar të energjisë elektrike rreth 1.365.077 kwh, është shoqëria “Leadd Energy” sh.p.k.

3. Koncesionar për HEC “Shemri”, me fuqi të instaluar 800 kw dhe prodhim mesatar të energjisë elektrike rreth 3.502.000 kwh, është shoqëria “Erald 2 Energy” sh.p.k.

- Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka njohur dhe ka pranuar me nënshkrimin e kontratës shtesë të koncesionit, ku në cilësinë e koncesionarit, nuk do të jetë më bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Oberaldi” sh.p.k. dhe “Lala” sh.p.k., por shoqëritë “Leadd Energy” sh.p.k. dhe “Erald 2 Energy” sh.p.k. Në këto kushte, licenca e shoqërisë “Erald Energjitik” sh.p.k., e humbet qëllimin për të cilin është lëshuar dhe duhet t’i hiqet mbajtësit. Si e tillë, ERE-s në zbatim të legjislacionit në fuqi i lind detyrimi të fillojë procedurën për heqjen e licencës së prodhimit të energjisë elektrike shoqërisë “Erald Energjitik” sh.p.k.

- “Erald Energjitik” sh.p.k. nuk do të ushtrojë më aktivitetin për të cilin është licencuar, por ia ka

transferuar këtë të drejtë me miratimin e autoritetit kontraktor (MIE) (referuar kontratës shtesë të koncesionit), dy subjekteve të reja tregtare pritëse shoqërisë koncesionare “Erald 2 Energy” sh.p.k., për prodhimin e energjisë nga HEC “Shëmri” sh.p.k. dhe shoqërisë koncesionare “Leadd Energy” sh.p.k., për prodhimin e energjisë nga HEC “Mgullë”.

- Shoqëria koncesionare “Erald 2 Energy” sh.p.k., autorizuar për prodhimin e energjisë nga HEC “Shëmri”, me fuqi të instaluar 280 kw dhe shoqëria koncesionare “Leadd Energy” sh.p.k., autorizuar për prodhimin e energjisë nga HEC “Mgullë”, me fuqi të instaluar 800 kw, nuk kanë nevojë të pajisen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike mbështetur në neni 37, pika 6, germa “b”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “Erald Energjitik” sh.p.k., me nr. 162, seria PV11K, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 91, datë 26.9.2011, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et “Shëmri” dhe “Mgullë”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë shoqërinë “Erald Energjitik” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S

Erjola Sadushi